

Vendim nr. 92 datë 28.04.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Elsa Toska,	Kryesuese
Genti Ibrahim, i,	Anëtar
Illir Toska,	Anëtar

në datën 28.04.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 1 (V) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: VALBONA KATORRI

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 17, datë 28.02.2022 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë; nr. 00-2022-4503 (369), datë 28.10.2022 të Kolegjit Administrative të Gjykatës së Lartë, si të papajftueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 41, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 1 i Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (Kolegji), pasi dëgjo i relatorin e çështjes Illir Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja Valbona Katorri ka në pronësi pasuritë e paluajtshme nr. 7/583, me sipërfaqe 90.0 m², nr. 7/584, me sipërfaqe 120 m² truall, nr. 7/585, me sipërfaqe 67 m² truall, Zona Kadastrale 8150, me vendndodhje në bulevardin “Bajram Curri”, Tiranë, si dhe pasurinë nr. 7/656, me sipërfaqe 144.0 m² truall, Zona Kadastrale 8150, me vendndodhje në rrugën “Ali Demi”, Tiranë.

2. Për zhvillimin e pronës kërkuesja ka pasur një komunikim të vazhdueshëm me Bashkinë e Tiranës, duke paraqitur kërkesa pranë këtij organi për hartimin e Planit të Detajuar Vendor (PDV), si dhe për miratimin e lejes zhvillimore në pasuritë e saj, kërkesa që, siç rezulton nga aktet bashkëlidhur kërkesës, nuk janë pranuar duke iu kthyer edhe dokumentacioni i paraqitur.

3. Me vendimin nr. V-1777/1, datë 01.02.2017, të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, është vendosur refuzimi i kërkesës për “Leje zhvillimi”, me arsyetimin se kërkuesja, mbështetur në vendimin nr. 9, datë 17.02.2016 të Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT) “Për zbatimin e planeve të përgjithshme vendore nga autoritetet vendore të zhvillimit të territorit”, duhet të aplikojë për miratimin e PDV-së të nënjesisë strukturore 1/1, faza e dytë, zona A1, duke e shoqëruar kërkesën me dokumentacionin tekniko-ligjor, sipas ligjit dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

4. Në vijim, kërkuesja ka paraqitur kërkesa pranë Bashkisë së Tiranë për hartimin e fazës së dytë të PDV-së në nënjesinë strukturore 1/1, zona A1, duke argumentuar se PDV-ja i nevojitet për të aplikuar për leje ndërtimi dhe zhvillimi.

5. Me vendimin nr. 1, datë 14.04.2017 (*vendimi nr. 1/2017*), KKT-ja ka miratuar Planin e Përgjithshëm Vendor (PPV) të Bashkisë së Tiranës.

6. Edhe pas këtij vendimi kërkuesja ka vijuar të paraqesë kërkesa pranë organeve administrative për miratimin e PDV-së për nënjesinë strukturore ku ndodhen pasuritë e saj, si dhe për pajisjen me dokumentacionin mbi të cilin është miratuar ky plan vendor.

7. Përveç rrugës administrative, siç rezulton nga aktet bashkëlidhur kërkesës, kërkuesja i është drejtuar edhe gjykatës me kërkesëpadi.

8. Në datën 24.05.2016 kërkuesja i është drejtuar gjykatës administrative me kërkesëpadi me objekt detyrimin e Bashkisë së Tiranës ta pajisë me dokumentacionin përkatës “Plan të detajuar vendor faza e dytë ose leje zhvillimi të pronës së saj”, sipas ankimeve pranë këtij institucioni, të shoqëruar me dokumentacionin përkatës, si edhe pagimin e dëmit të shkaktuar nga kjo vonesë.

9. Me vendimin nr. 4781, datë 17.10.2016, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë si të pabazuar në prova dhe në ligj. Sipas saj, padia e paraqitur nuk ka objekt sipas nenit 17, shkronja “ç”, të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*). Gjykata ka vlerësuar se paditësja ka aplikuar pranë Bashkisë së Tiranës për t`u pajisur me PDV-në faza e dytë ose leje zhvillimore dhe i është kthyer përgjigje se nuk është miratuar taksa e lejes së ndërtimit nga Këshilli Bashkiak, ndaj kërkesa nuk mund të merrej në shqyrtim, dhe se nuk kanë dalë aktet nënligjore në zbatim të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” (*ligji nr. 107/2014*), që ka qenë në fuqi në kohën që paditësja ka aplikuar për leje zhvillimore. Koncepti i “miratimit në heshtje”, që parashikon neni 44, pika 3, i këtij ligji, nuk zbatohet për lejet e ndërtimit në kompetencë të KKT-së dhe punime të tjera. Në rastin konkret, struktura përgjegjëse e planifikimit pranë autoritetit vendor ka dhënë mendimin e saj negativ në lidhje me kërkesën e kërkueses, duke e refuzuar kërkesën për pajisjen me leje zhvillimore dhe duke parashtruar edhe arsyet në këtë drejtim. Për rrjedhojë, sipas gjykatës së shkallës së parë, padia nuk ka objekt, pasi nga ana e palës së paditur është refuzuar leja zhvillimore, ndaj paditësja, nëse nuk është dakord me këtë veprim, duhet të paraqesë në gjykatë padinë e duhur, duke kërkuar shfuqizimin e aktit administrativ që ka sjellë pasoja për të.

10. Mbi ankimin e kërkueses, me vendimin nr. 3191 (86-2019-3612), datë 12.12.2019, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Nga të dhënat e faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë kjo çështje rezulton të jetë regjistruar në atë gjykatë në datën 19.06.2020 dhe ende nuk ka një vendim për të.

11. Me kërkesëpadinë e datës 01.08.2017, kërkuësja ka kundërshtuar në gjykatë edhe vendimin nr. 1/2017 të KKT-së (procesi gjyqësor objekt i kërkesës në shqyrtim), me pretendimin se ky akt i ka cenuar të drejtën e pronësisë, duke kërkuar: *“Anulimin dhe shfuqizimin e vendimit nr. 1/2017 të KKT-së, për pikën “harta e rrjetit rrugor të propozuar”, për sa i përket rrjetit rrugor të propozuar që cenon të drejtën e pronësisë së paditëses, të ndodhur në Zonën Kadastrale 8150... Sigurimin e padisë, bllokimin e zbatimit të propozimit të segmentit të rrugës, të propozuar me vendimin nr. 1/2017, nga organi përkatës.”*.

12. Me vendimin nr. 3889, datë 12.10.2017, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur të deklarojë moskompetencën funksionale për gjykimin e kësaj mosmarrëveshjeje administrative dhe dërgimin e akteve për kompetencë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, ku çështja është regjistruar në datën 27.10.2017.

13. Me vendimin nr. 197 akti, datë 17.11.2017, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur të refuzojë kërkesën për marrjen e masës së sigurimit të padisë “Bllokimin e zbatimit të propozimit të segmentit të rrugës, të propozuar me vendimin nr. 1/2017, nga organi përkatës”. Ky vendim është bërë objekt shqyrtimi nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i vënë në lëvizje mbi bazën e ankimit të kërkueses, i cili, me vendimin nr. 00-2022-671, datë 07.03.2022, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit.

14. Në vijim, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 197/68 akti, datë 15.01.2018, ka vendosur të ngrejë para Gjykatës së Lartë mosmarrëveshjen në lidhje me kompetencën funksionale për gjykimin e kësaj çështjeje. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2018-503, datë 10.04.2018, ka vendosur të lërë në fuqi vendimin nr. 3889, datë 12.10.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

15. Në seancën gjyqësore të datës 29.06.2018, në Gjykatën Administrative të Apelit, kërkuësja ka kërkuar pezullimin e gjykimit të çështjes deri në përfundimin e gjykimit të çështjes tjetër të regjistruar në po atë gjykatë për detyrimin e Bashkisë së Tiranës për pajisjen e saj me dokumentacionin përkatës, PDV-në faza e dytë ose leje zhvillimi të pronës së saj. Me vendimin e datës 29.06.2018, Gjykata Administrative e Apelit ka pranuar kërkesën për pezullimin e gjykimit të kësaj çështjeje administrative deri në përfundim të shqyrtimit në po atë gjykatë të padisë tjetër të paraqitur nga kërkuësja.

16. Në përfundim të këtij gjykimi, në lidhje me kërkesëpadinë, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 17, datë 28.02.2022, ka vendosur: *“Pushimin e shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Apelit Administrativ”*. Ajo ka vlerësuar se vendimi nr. 1/2017 i KKT-së, me të cilin është miratuar PPV-ja e Bashkisë së Tiranës, është një akt administrativ normativ, pra joshterues në zbatimin e tij, ndaj individët që pretendojnë se u cenohen interesat nëpërmjet këtij akti, duhet të vënë në diskutim ligjshmërinë vetëm nëpërmjet akteve individuale që do të disponohen në bazë të tij. Ky akt nuk rezulton drejtpërdrejt i zbatueshëm dhe mjeti ligjor për mbrojtjen nga paditësja të interesave të saj është padia me objekt aktin administrativ individual që do të disponohet në bazë të tij, sikurse mund të jetë refuzimi nga pala e paditur i lejes zhvillimore, nëse paditësja do të parashtrijë një kërkim të tillë në bazë të aktit nënligjor në fuqi, vendimit nr. 1/2017 të KKT-së. Për sa më sipër, Gjykata Administrative e Apelit ka çmuar se akti me të cilin ajo është vënë në lëvizje përbën padi që nuk mund të ngrihet, për shkak të moslegjitimitit aktiv formal-procedural të paditëses për të goditur aktin normativ nënligjor, vendimin nr. 1/2017 të

KKT-së (*shih faqet 25 dhe 26 të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit*). Kundër këtij vendimi kërkuesja ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë.

17. Me vendimin nr. 00-2022-4503 (369), datë 28.10.2022, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur: “*Lënien në fuqi të vendimit nr. 17, datë 28.02.2022 të Gjykatës Administrative të Apelit*”. Sipas asaj gjykate, paditësja qartësisht ka një mjet tjetër në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të saj individuale, që është padia ndaj aktit zbatues të nxjerrë nga pala e paditur, në ekzekutim të parashikimit abstrakt të aktit nënligjor normativ objekt gjykimi. Në këto kushte, në kuptim të nenit 15, shkronja “d”, të ligjit nr. 49/2012, përfundimi i arritur nga Gjykata Administrative e Apelit, se pala paditëse Valbona Kotorri nuk mbart legjitimitet aktiv për të kundërshtuar ligjshmërinë e aktit nënligjor normativ objekt gjykimi, është rrjedhojë e respektimit dhe zbatimit të drejtë të kërkesave të ligjit procedural (*shih paragrafin 25 të vendimit të Kolegjit Administrativ*). Akti i kundërshtuar nuk është direkt i zbatueshëm, pasi ai përfaqëson një akt të karakterit të përgjithshëm, programatik, por zbatohet përmes akteve të tjera zbatuese dhe në fund përmes akteve individuale, siç është leja zhvillimore, dhënia (sipas kushteve të caktuara) ose jo e së cilës mund të kundërshtohet në mënyrë individuale nga paditësja, me qëllim mbrojtjen e interesit të saj personal të ligjshëm. Në vlerësimin e Gjykatës së Lartë, në atë gjykim, nëpërmjet gjykimit incidental, sipas nenit 37 të ligjit nr. 49/2012, paditësja mund të pretendojë se akti administrativ individual, që ka dalë në zbatim të një akti nënligjor normativ të paligjshëm, cenon të drejtat e saj dhe, në këtë rast, gjykata ka detyrimin të marrë në shqyrtim këtë pretendim (*shih paragrafët 26 dhe 27 të vendimit të Kolegjit Administrativ*).

18. Kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual sipas objektit të mësipërm, i cili është regjistruar në datën 27.02.2023.

II

Pretendimet e kërkueses

19. **Kërkuesja** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet e kundërshtuara kanë cenuar:

- 19.1. *Të drejtën e aksesit të lidhur me të drejtën e pronës private*, për shkak të arsyesimit të këtyre vendimeve që kanë vendosur pushimin e gjykimit. Kërkuesja, sipas certifikatave të pronësisë, është pronare e katër pasurive të paluajtshme, të cilat preken nga segmenti rrugor i miratuar me vendimin nr. 1/2017 të KKT-së, për rrjedhojë interesi i saj për kundërshtimin e këtij akti është i drejtpërdrejtë dhe i

ligjshëm. Prona e kërkueses ka ndryshuar nga shesh ndërtimi, zonë banimi, nëpërmjet devijimit të rrugës dhe kalimit të saj përmes kësaj prone, çka ka ndryshuar kufijtë e PDV-së duke e ndarë pronën në dy PDV dhe duke e kualifikuar përfundimisht në zonën TR88, e cila nuk ka një PDV të miratuar. Edhe pse Bashkia e Tiranës në përgjigjet administrative është shprehur se kërkuesja mund ta zhvillojë pronën, nga ana tjetër ka penguar zhvillimin e saj. Kërkuesja nuk ka mjet tjetër ankimi përveç atij në gjykatën administrative.

- 19.2. *Parimin e sigurisë juridike dhe pritshmëritë e ligjshme të lidhur me të drejtën e pronës private*, pasi megjithëse plani rregullues që prej vitit 1989 ka pasur të parashikuar në atë zonë shesh ndërtimi dhe godina banimi, KKT-ja e ka ndryshuar atë duke miratuar ndërtimin e një rruge në pronën e kërkueses. Në të gjitha planet rregulluese të mëparshme, duke filluar nga ai i vitit 1989 e në vijim, kjo pronë ka qenë e destinuar për zhvillim e banim dhe që prej vitit 1994 mbi të ka pasur dyqane, duke qenë aktualisht e rrethuar. Kërkuesja ka investuar vlera monetare mbi këtë pronë, jo vetëm në procese gjyqësore, por edhe për hartimin e PDV-së për të gjithë zonën, e cila iu paraqit zyrtarisht Bashkisë së Tiranës. Kjo e fundit ka miratuar PDV-në e hartuar nga kërkuesja për fazën e parë dhe në vazhdimësi i ka drejtuar asaj shkresa në të cilat shprehet se mund ta zhvillojë pronën, si dhe kërkesa për plotësimin e dokumentacionit për miratimin e PDV-së faza e dytë. Megjithatë, në përfundim, KKT-ja ka vendosur ndërtimin e një rruge dhe ndarjen e pronës së kërkueses në dy PDV të ndryshme. Propozimi i rrugës është bërë në mënyrë joligjore dhe kërkuesja nuk është njoftuar se çfarë ka ndodhur me ndryshimin e zhvillimit të pronës së saj sipas ligjit nr. 107/2014 dhe nëse ka të drejtë ta zhvillojë në këto kushte të reja. Pasi i është drejtuar Bashkisë së Tiranës për informacion, kërkuesja ka marrë dijeni për aktin e kundërshtuar dhe se prona e saj është e ndarë në dy zona, me rrugë në mes, çka e bën të pamundur zhvillimin e saj.
- 19.3. *Të drejtën për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm*, pasi gjykimi i çështjes së kërkueses ka filluar në vitin 2017 dhe shqyrtimi i saj në të dyja gjykatat ka zgjatur për një periudhë 5-vjeçare.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkueses

20. Çështja e legjitimit (locus standi) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

21. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, kërkuësja legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

22. Lidhur me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, individi mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 35, datë 01.11.2021; nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Sipas Gjykatës, si rregull, ligji zbatohet përmes akteve të organeve publike ose vendimeve gjyqësore, prandaj individi duhet, së pari, t’i kundërshtojë ato para gjykatave kompetente, duke shteruar të gjitha mjetet juridike që parashikon legjislacioni i brendshëm. Kjo ka rëndësi edhe për të provuar se kërkuësi është prekur personalisht, drejtpërdrejt dhe realisht. Megjithatë, ligji ka parashikuar edhe rastet kur përmbushja e këtij kriteri është e pamundur (legjislacioni nuk parashikon mjete juridike ose ato janë joefektive). Meqenëse mjeti juridik mund të jetë i ndryshëm, në varësi të llojit të ankimit, efektiviteti i tij vlerësohet jo thjesht nga fakti që është parashikuar me ligj, por edhe nga zbatueshmëria e tij (*shih vendimin nr. 31, datë 04.10.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Kolegji vëren se kërkesja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual duke kërkuar në objektin e tij shfuqizimin e vendimeve gjyqësore që kanë vendosur pushimin e gjykimit, por pretendimet e saj, në thelb, i referohen përmbajtjes së vendimit nr. 1/2017 të KKT-së, i cili, sipas kërkeses, i ka cenuar të drejtën e pronës private, duke bërë të pamundur zhvillimin e saj. Referuar vendimeve gjyqësore të kundërshtuara rezulton se kërkesja ka kundërshtuar drejtpërdrejt në gjykatë vendimin nr. 1/2017 të KKT-së, me të cilin është miratuar PPV-ja e Bashkisë së Tiranës, me pretendimin se ky akt e prek në pronën e saj, duke përcaktuar kalimin përmes saj të një rruge, çka e ndan atë në dy zona të veçanta. Po ashtu, referuar akteve bashkëlidhur kërkesës, nuk rezulton që kërkesja të ketë kundërshtuar në gjykatë aktin administrativ individual, që është vendimi nr. V-1777/1, datë 01.02.2017 i Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, me të cilin është refuzuar kërkesa për “Leje zhvillimi”.

25. Në lidhje me objektin e padisë së paraqitur nga kërkesja, gjykatat e zakonshme kanë arritur në përfundimin se asaj i mungon legjitimimi aktiv për kundërshtimin e vendimit nr. 1/2017 të KKT-së. Me konkretisht, Gjykata Administrative e Apelit ka vlerësuar se ky akt ka natyrë normative dhe jo individuale dhe duke qenë joshterues në zbatimin e tij, individët që pretendojnë se ai u cenon interesat e ligjshme, duhet të vënë në diskutim ligjshmërinë vetëm nëpërmjet akteve individuale që do të disponohen në bazë të tij. Në të njëjtën linjë, edhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se kërkesja qartësisht ka një mjet tjetër në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të saj individuale, që është padia ndaj aktit zbatues të nxjerrë nga pala e paditur, në ekzekutim të parashikimit abstrakt të aktit nënligjor normativ objekt gjykimi. Sipas asaj gjykate, akti i kundërshtuar nuk është direkt i zbatueshëm, pasi ai përfaqëson një akt të karakterit të përgjithshëm, programatik, por zbatohet përmes akteve të tjera zbatuese dhe në fund përmes akteve individuale, siç është leja zhvillimore, dhënia ose jo e së cilës mund të kundërshtohet në mënyrë individuale nga kërkesja, me qëllim mbrojtjen e interesit të saj personal të ligjshëm.

26. Kolegji vëren se qëllimi i shterimit të mjeteve juridike, para së gjithash, vlen për t’iu ofruar mundësinë e korrigjimit të shkëljes, së pari gjykatave të zakonshme. Ai bazohet në premisën se këto gjykata e kanë mundësinë e korrigjimit të saj dhe se kontrolli kushtetues ka natyrë subsidiare. Megjithatë, kjo nuk duhet të jetë vetëm një mundësi që i kërkohet individit të verifikohet formalisht, por duhet që, së pari, gjykatat e zakonshme të kenë kompetencën për të vendosur në lidhje me një çështje të caktuar, të shtruar para tyre për zgjidhje, në kuptimin që

çështjet që më pas i nënshtrohen gjykimit kushtetues të jenë vlerësuar dhe t'u jetë dhënë një përgjigje përfundimtare nga ato gjykata, në lidhje me bazueshmërinë e tyre.

27. Referuar ligjit nr. 107/2014, në pikën 1 të nenit 20 të tij janë përcaktuar objektivat e PPV-së, kurse në pikën 2 parashikohet se ai zbatohet nëpërmjet planeve sektoriale, PDV-ve dhe lejeve të zhvillimit. Kurse në vijim parashikohen rregullat dhe procedurat për miratimin e dokumenteve të planifikimit dhe lejes së zhvillimit e asaj të ndërtimit. Në nenin 22, pika 2, është përcaktuar se PDV-të hartohen me nismë publike ose private në zona të cilat janë: a) një njësi strukturore; b) disa njësi strukturore bashkë; c) çdo zonë me prioritet për zhvillim, e përcaktuar si e tillë në PPV-në e territorit. Sipas nenit 37 të ligjit, zhvillimi lejohet vetëm në kushtet e përcaktuara nga dokumentet e planifikimit ose, në mungesë të tyre, të aprovuara nga organi kompetent, të cilat shërbejnë si bazë për hartimin e dokumentacionit që shoqëron kërkesën për leje ndërtimi. Sipas pikës 2 të nenit 38 kjo leje është e nevojshme për çdo parcelë dhe jepet me miratimin e PDV-së, kurse në rastin e parcelave për të cilat nuk parashikohet hartimi i një PDV-je, jepet me miratimin e PPV-së.

28. Për sa më sipër, Kolegji vëren se për zbatimin e PPV-së nevojitet miratimi i akteve të tjera që e bëjnë atë të zbatueshme, përfshirë ato me natyrë individuale, të cilat mund të kundërshtohen në gjykatë në rast se provohet cenimi i drejtpërdrejtë i të drejtave kushtetuese të kërkuases. Në këtë kuptim, për më tepër në kushtet kur kërkuësja është bërë me dije nga gjykatat e zakonshme për ekzistencën e mjeteve të tjera juridike në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të saj individuale, Kolegji vlerëson se ajo nuk ka arritur të argumentojë para Gjykatës se përse paraqitja e ankimit kushtetues individual është mjeti i fundit në dispozicion të saj për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që pretendon se i janë cenuar, në këtë rast e drejta e pronës private.

29. Në lidhje me procesin gjyqësor të kundërshtuar, kërkuësja ka pretenduar edhe cenimin e standardit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, pasi gjykimi i çështjes ka filluar në vitin 2017 (kur është paraqitur kërkesëpadia) dhe shqyrtimi i saj ka zgjatur për një periudhë 5-vjeçare. Këtë pretendim kërkuësja e ka parashtruar drejtpërdrejt në ankimin kushtetues individual, pa shteruar paraprakisht mjetet juridike efektive në dispozicion të saj, sipas neneve 399/1 – 399/12 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), pra pa iu drejtuar gjykatës kompetente me kërkesë për konstatimin e cenimit dhe përshpejtimin e procedurave. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se, si rregull, shqyrtimi i këtyre lloj çështjesh dhe vlerësimi përfundimtar në lidhje me kohëzgjatjen e arsyeshme të gjykimit duhet të bëhet nga gjykatat e zakonshme, sipas kompetencës që parashikon KPC-ja, në përputhje me parimin e subsidiaritetit. Në analizë të

kriterit të shterimit të mjeteve juridike efektive, Gjykata ka pranuar se në parim mjetet e parashikuara nga nenet 399/1 e vijues të KPC-së janë efektive, ndërsa në praktikë efektiviteti i tyre duhet shqyrtuar nën dritën e rrethanave të çdo rasti konkret (*shih vendimet nr. 3, datë 17.02.2022; nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Për sa më lart, Kolegji çmon se në rastin konkret kërkesja nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion të saj në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm përpara se t'i drejtohej kësaj Gjykate.

31. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 31/a, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.